LIGJ
Nr. 10 118, datë 23.4.2009

PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË PËRDORIMIT, PËR 15 VJET, NË BREZIN E FREKUENCAVE E-GSM DHE GSM 1800, BASHKIMIT TË OFERTUESVE, PËRFAQËSUAR NGA POSTË TELEKOMUNIKACIONI I KOSOVËS SHA, SIPAS PROCEDURËS "TENDER I HAPUR NDËRKOMBËTAR" TË DATËS 20.2.2009

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Dhënien e së drejtës së përdorimit, për 15 vjet, kundrejt çmimit 7 200 000 (shtatë milionë e dyqind mijë) euro, në brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, bashkimit të ofertuesve, të përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha, sipas kushteve të ofertës, të dorëzuar tek Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në përputhje me kërkesat e dokumentacionit standard të procedurës "Tender i hapur ndërkombëtar" të datës 20.2.2009.

Neni 2

Ndalohet, pa vënë në efiçencë shërbimin e telekomunikacionit në brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, çdo transferim pakete aksionesh apo të drejtash, sipas nenit 1 të këtij ligji, nga subjekti Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha, me adresë: Lagjja "Dardania", Prishtinë-Kosovë, të tretëve, përfshirë dhe bashkimit të ofertuesve të tjerë. Ky ndalim përfundon në çdo kohë, kur bashkimi i ofertuesve, përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha ka bërë efiçent rrjetin në parametrat: mbulim 95 për qind të popullsisë dhe 85 për qind të territorit.

Kuvendi i Shqipërisë mund të vendosë ndryshe, me kërkesë të motivuar të subjektit Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha, për rrethana të veçanta të tij, të tilla si: likuidim, falimentim apo gjendje paaftësie paguese të këtij subjekti.

Neni 3

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, t'u dërgojë njoftimin fituesve, bashkimit të ofertuesve, përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha dhe të vijojë procedurën për autorizimin individual, sipas dokumentacionit të tenderit.

Neni 4

Ky ligj nuk krijon asnjë efekt kur bashkimi i ofertuesve, përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha, nuk likuidon, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit, çmimin e ofertës prej 7 200 000 (shtatë milionë e dyqind mijë) eurosh.

Kur bashkimi i ofertuesve, përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha, nuk likuidon në masë të plotë shumën 7 200 000 (shtatë milionë e dyqind mijë) euro, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit, garancia e shoqërisë së sigurimeve ALBSIG, e derdhur për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si depozitë e rimbursueshme, në shumën 100 000 (njëqind mijë) euro, në numër serie 11086639, datë 20.2.2009, e vlefshme për

periudhën 150 ditë kalendarike pas datës 20.2.2009, kalon për llogari të shtetit shqiptar.

Neni 5

Dokumentacioni standard i tenderit të hapur ndërkombëtar, i hartuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe oferta e subjektit, dorëzuar pranë këtij autoriteti, janë pjesë përbërëse të këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6159, datë 7.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi